



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:042307

Datë: 21.07.2023

Numri i dokumentit: 04510930

Ac.nr.7783/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Ardian Ajvazi - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S. A nga fshati P..., Komuna e V..., kundër të paditurit R. Pnga fshati P..., Komuna e V..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E. P - avokat në V..., lidhur me kompensimin e fitimit të humbur, vlera e kontestit 8,011.85 euro, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti C.nr.126/2014, të datës 25.08.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **10.07.2023**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditësit S. A nga fshati P..., Komuna e V..., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti C.nr.126/2014, i datës 25.08.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.126/2014, të datës 25.08.2021, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit S. A(M) nga fshati P..., Komuna e V..., me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material për shkak të fitimit të humbur në shumën prej 8,011.85 euro, për shkak të pengim posedimit në mbjelljen e kulturave bujqësore të grurit dhe misrit, në sipërfaqe prej 38902 m² (3 hektarë, 89 ari e 02 m²) të ngastrave kadastrale nr.11-0, 12-0 dhe 872-0, të tria në Zonën Kadastrale në P..., të evidentuara në pronësi të paditësit. Ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka detyruar paditësin t'ia kompensoj të paditurit R. Pshpenzimet e procedurës kontestimore në shumën 540 euro, në afat prej 15 nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që

Gjykata e Apelit aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, ose aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje në shkallën e parë.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit **është e pathemeltë**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datën 25.04.2016, ka paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurit R. P me të cilën ka kërkuar që të detyrohet ky i fundit t'ia kompenoj dëmin material për shkak të fitimit të humbur në shumën prej 8,011.85 euro, për shkak të pengim posedimit në mbjelljen e kulturave bujqësore të grurit dhe misrit, në sipërfaqe prej 38902 m² të ngastrave kadastrale nr.11-0, 12-0 dhe 872-0, në Zonën Kadastrale në P.... si dhe ka kërkuar edhe kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.126/2014, të datës 25.08.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se gjykata e bazon vendimin e saj për refuzimin e kërkesëpadisë në provën kryesore që është deklarata e vet paditësit S. Atë dhënë në cilësinë e palës në seancën e datës 21.07.2021, ku prezent ishte edhe i padituri R. P, i cili po ashtu kishte deklaruar në cilësi të palës, të cilat deklarata përputheshin mes vete. Nga ajo seancë gjykata ka konstatuar se i padituri nuk e kishte penguar paditësin në mbjelljen me kultura bujqësore (kryesisht grurë dhe misër) ngastrat me nr.11-0, 12-0 dhe 872-0, në ZK P..., në periudhën se kur është kërkuar kompensimi nga pala paditëse, e cila në seancën e datës 09.03.2020, përmes të autorizuarit të tij kishte precizuar kohën e shkaktimit të pengim posedimit nga data 13.04.2014 e në vazhdimësi deri me 18.10.2019. Tutje gjykata e shkallës së parë ka theksuar se vet paditësi gjatë shqyrtimit të lëndës me shenjen C.nr.391/2014 të pengim posedimit kishte deklaruar se i padituri R. Pe kishte penguar deri në ngritjen e kësaj padie 25.04.2014. Ndërsa, me rastin e deklarimit të tij në cilësinë e paditësit në seancën e datës 21.07.2021, paditësi kishte deklaruar se sa i përket ngastrave nr. 11-0 dhe 12-0 pas nxjerrjes së vendimit të gjykatës (vendimi C.nr.391/2014, i datës 25.02.2015, lidhur me pengim posedimin), nuk e ka penguar R.P, ndërsa sa i përket ngastrës nr.872-0, djali i R. kishte dal dhe i kishte thënë personit që e kisha autorizuar ta lëvroj këtë ngastër, se po ta bëjë me dije se ky (S), ka problem me këtë arë. Më tej ka, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar gjykata nuk mund ta pranoj faktin se i padituri-R. P përmes djalit të tij e kishte penguar paditësin ta lëvroj arën, sepse në rastin konkret as R nuk ka qenë prezent po t'i kishte thënë këto fjalë, por as paditësi nuk ishte në rastin konkret, pra ishin persona të tretë. Në anën tjetër i padituri vazhdimisht edhe kur nuk kishte të autorizuar, por edhe në cilësi të paditurit ka deklaruar se nuk e kam penguar dhe nuk do ta pengoj paditësin që t'i mbjell tri ngastrat kontestuese, duke deklaruar se nuk ka kurrfarë interesi juridik ta pengoj paditësin. Prandaj gjykata duke vlerësuar deklaratat dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse, nuk e mori parasysh pretendimin e të autorizuarit të paditësit, i cili në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se kompensimi i dëmit që buron nga fitimi i humbur,

është rezultat i pengimit në posedim i vërtetuar edhe me vendim gjyqësor, për arsye se pikërisht ky përfaqësues ka kërkuar fitimin e humbur pas nxjerrjes së Aktvendimit C.nr.391/2014, kurse vet paditësi kishte thënë të kundërtën. Gjykata ka vlerësuar si pretendim të pabazuar edhe pretendimin e të autorizuarit të paditësit se pengim posedimi është bërë duke kullotur delet, sepse po të shkaktuhej dëmi nga delet, do të vendosej për dëmin e shkaktuar nga kafshët (pra dëmi do të ishte konkret), e deri tek pretendimet lidhur hapësirat e krijuara si rrugë alternative, ngase kërkesa e tij ishte vlerësimi i dëmit nga fitimi i humbur nga data 13.04.2014 e në vazhdimësi deri me 18.10.2019. Dallimi mes deklarimeve të vet paditësit dhe të autorizuarit të tij ishte esencial sa i përket pretendimeve kohore kur i padituri e kishte penguar paditësin në mbjelljen e kulturave bujqësore, sepse paditësi pohonte se ishte penguar deri në nxjerrjen e aktvendimit C.nr.391/2014, të datës 25.02.2015, ndërsa i autorizuari i tij pretendonte se paditësi ishte penguar pas kësaj date në mënyrë të vazhdueshme, andaj edhe kërkesëpadia e tij bazohej pas datës së vërtetuar të pengim posedimit, për të cilën u refuzua në tërësi si e pabazuar. Vendimin për shpenizmet procedurale e ka mbështetur në nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ndërsa pretendimet tjera për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga ana e ankuesit nuk qëndrojnë.

Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes rreth kërkesëpadi së paditësit, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, e si rezultat i kësaj, drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, për të cilat arsye, aktgjykimi i atakuar është dashur të vërtetohet në tërësi. Gjithashtu, edhe dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke krijuar kështu harmoni logjike e juridike mes dispozitivit e arsyetimit. Përkatesisht, i njëjti është hartuar në përputhje të plotë me nenin 160 të LPK-së. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për pathemelsinë e kërkesëpadi së paditësit, e në lidhshmëri me këtë, ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Për këto arsye, refuzohen si të pabazuara pretendimet ankimore sipas të cilave gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të tilla, me rastin e hartimit të vendimit gjyqësor.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore sipas të cilave gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar si duhet gjendjen faktike dhe se nuk ka trajtuar siç duhet pretendimet e paditësit, të shprehura në kërkesëpadi. Nga provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, përkatësisht, nga vet deklaratimet e paditësit i dëgjuar në cilësinë e palës i cili kishte deklaruar se i padituri nuk e kishte penguar paditësin në mbjelljen me kultura bujqësore ngastrat me nr.11-0, 12-0 dhe 872-0, në ZK P..., në periudhën për të cilën është kërkuar kompensimi, pra nga data 13.04.2014 e në vazhdimësi deri me 18.10.2019. Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se nga provat e administruara është provuar fakti se paditësi nuk ka paraqitur prova për të vërtetuar pretendimet e tij, për dëmin e shkaktuar si fitimin e humbur për kohën dhe periudhën për të cilën ka kërkuar kompensimin. Duke u bazuar në nenin 173 par. 1 të LMD-së, në të cilin është përcaktuar se *“I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur”*, kurse në paragrafin 3 të po të njëjtit nen thuhet *”për vlerësimin e lartësisë së fitimit të*

humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmerr veprimin”, rezulton se në rastin konkret nuk është provuar në asnjë mënyrë që paditësi ka pësuar dëm material – fitim të humbur siç e parasheh dispozita e lartcekur. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se këtu i padituri nuk ka për detyrim që t’ia kompensoj paditësit fitimin e humbur, pasi që paditësi nuk e ka provuar me prova të mjaftueshme një gjë të tillë, por përkundrazi në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 21.07.2021. i njëjti në cilësi të palës ka deklaruar se i padituri nuk e ka penguar në mbjelljen e kulturave bujqësore në përiudhën për të cilën i autorizuari i tij e kishte precizuar kërkesëpadinë e paditësit. Kështu që edhe për Gjykatën e Apelit është i pranueshëm qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë se nga provat e administruara nuk është provuar fakti se me veprimet ose mos veprimet e të paditurit, këtu paditësit i është pamundësuar shfrytëzimi i pronës së tij, përkatësisht i është pamundësuar që të veprojë në rritjen e vlerës së saj, apo të jenë penguar që të realizojnë të ardhura prej saj.

Përfundimisht, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pabazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësit është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e drejtë të dispozitave materialo - juridike në të cilat është thirrur me rastin e vendosjes, nga edhe ka rrjedhur pabazueshmëria e kërkesëpadisë së paditësit, pasi që zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadia e paditësit në rastin konkret është e pathemeltë. Për këtë arsye gjykata e shkallës së dytë gjen se ankesa e paditësit në rastin konkret është e pathemeltë.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, i shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të paditësit, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7783/21, datë 10.07.2023

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka